



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
QENDRA STUDIMORE PËR SHËNDETIN PUBLIK

---

**RREGULLORJA**  
**E QENDRËS STUDIMORE PËR SHËNDETIN PUBLIK,**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' I VLORËS**

Miratuar me Vendim Nr.13, dt. 21.01.2017 të Senatit Akademik të Universitetit 'Ismael Qemali'  
Vlorë



**RREGULLORE  
PËR FUNKSIONIMIN E QENDRËS STUDIMORE TË SHËNDETIT  
PUBLIK NË FAKULTETIN E SHËNDETIT PUBLIK  
PRANË UNIVERSITETIT TË VLORËS  
"ISMAIL QEMALI"**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME**

**Neni 1**

**Baza ligjore e Rregullores**

Rregullorja "Për funksionimin e Qendrës Studimore të Shëndetit Publik në Fakultetin e Shëndetit Publik, pranë Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë e kësaj Qendre, krijimi i së cilës është parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të Nenit 26 të këtij Ligji për "Qendrat Kërkimore-Shkencore" dhe realizuar me Vendim të senatit Akademik të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" Nr 81, Datë 12.12.2016 "Për Shndërrimin e Njesisë Bazë të Shëndetit Publik në Qendër Kërkimore –Shkencore të Fakultetit të Shëndetit Publik me emërtimin Qendër Studimore për Shëndetin Publik .

**Neni 2**

**Statusi juridik**

Qendra Studimore për Shëndetin Publik funksionon si njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shëndetit Publik.

**Neni 3**

**Emërtimi i shkurtuar dhe selia**

Emërtimi i shkurtuar i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik është "QSSHHP".

Selia e saj ndodhet në Vlorë në adresën: Fakulteti i Shëndetit Publik Godina B, Rruga Sulejman Delvina 9400.



## KREU II

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

#### Neni 4

#### **Misioni dhe objektivi i rregullores së QSSHP**

Misioni dhe objektivi i Rregullores “Për funksionimin e Qendrës Studimore për Shëndetin Publik në FSHP” ka për qëllim menaxhimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe zhvillimit të Fakultetit të Shëndetit Publik të Universitetit ‘Ismael Qemali’ Vlorë, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj dhe e shtrin veprimin e saj mbi gjithë Fakultetin e Shëndetit Publik, njësitë përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, dhe bashkëpunëtorët e institucionit.

Rregullorja e Qendrës Studimore për Shëndetin Publik përcakton misionin e studimeve dhe projekteve në fushën Kërkimore–Shkencore të Shëndetit Publik në Fakultetin e Shëndetit Publik, vendos rregullat normative të organizimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e projekteve, për kërkimin, për vlerësimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

#### Neni 5

#### **Misioni i QSSHP**

Misioni i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik në FSHP është të vlerësojë, të marrë financime nga granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese ku përfshihen fondet për kërkimin shkencor, të monitorojë dhe të administrojë studimet dhe projektet në fushën e Shkencës dhe të Kërkimit në Fakultetin e Shëndetit Publik.

Gjithashtu, QSSHP ka si qëllim menaxhimin e projekteve dhe studimeve në fushën e Shëndetit Publik si dhe transferimin, modernizimin dhe rinovimin e teknologjive të tyre. Qendra do të funksionojë si një strukturë koordinuese për studime dhe projekte brenda Fakultetit të Shëndetit Publik dhe grupeve kërkimore shkencore të njësisë të tjera bazë, dhe bashkëpunime me Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe Institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit bazuar në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit midis Fakultetit të Shëndetit Publik dhe institucioneve të ndryshme.

QSSHP për çështjet e përmbajtjes dhe të vlerësimit të studimeve e të projekteve, mbështetet me ekspertizë nga komisionet e përhershme për përcaktimin e politikave të kërkimit shkencor, që propozohen nga Drejtusi i Qendrës dhe miratohen nga stafi akademik i qendres, në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj qendre.



Neni 6

**Qëllimet bazë të QSSHP**

- Qendra Studimore për Shëndetin Publik është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi në fushën e shëndetit në përgjithësi dhe atë të shëndetit publik në veçanti.
- Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve “Master i shkencave” dhe “Doktoratë”, të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës.
- Qëllimi bazë është të siguroj mbrojtjen e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe promovimin shëndetësor të të gjithë popullatës (komunitetit) në sajë të ofrimit të kujdesit klinik cilësor bazuar në evidencë nëpërmjet:
  - Identifikimit të determinantëve mjedisorë dhe gjenetikë të shëndetit dhe sëmundshmërisë në komunitet.
  - Zhvillimin dhe testimin e interventeve inovatore në shëndetin publik për promovimin e mirëqënies dhe reduktimin e sëmundshmërisë.
  - Metodave efektive të parandalimit të sëmundjeve kronike (kancerin, diabetin, sëmundjet kardiovaskulare).
  - Promocion shëndetësor.
  - Ushqyerjen, aktivitetin fizik dhe obezitetin.
  - Shëndetin mendor të popullatës.
  - Tipit të shërbimeve shëndetësore (studime analitike me bazë *check-up*).
  - Metodave të avancuara të sigurimit të shërbimeve shëndetësore në popullatë.
  - Ngritjes së politikave shëndetsore të shëndetit publik në funksion të arritjes së standarteve bashkëkohore në këtë fushë.
- duke edukuar individë që janë dhe do të jenë pjesë e kujdesit shëndetësor (personelin shëndetësor në komunitet) dhe anëtarët e komunitetit që të marrin vendime të informuara në lidhje me shëndetin e tyre, në funksion të përmirësimit të shëndetit të popullatës, nëpërmjet angazhimit të pedagogëve dhe studentëve të FSHP.
- Qendra, nëpërmjet anëtarëve të saj, siguron mbështetje për studimin, koordinimin, implementimin dhe përhapjen e kërkimit klinik nga kërkuesit shkencor të FSHP, me fokus sigurinë e pacientit, vazhdimësinë e kujdesit dhe pjesëmarrjen e informuar. Gjithashtu, Qendra ofron mbështetje për trajnimin e gjenerateve të reja të kërkuesve në fushën e kujdesit shëndetësor.
- Objektivi është ofrimi i programeve specializuese pasuniversitare si dhe krijimi i një modeli të veçantë të kujdesit infermieror në praktikën klinike. Ky model do të përcaktoj rolet dhe ndihmesën e infermierëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e kërkimit shkencor infermieror nëpërmjet sigurimit të kujdesit dhe mbështetjes së duhur pjesëmarrësve, si dhe implementimi i studimeve në përputhje me bio-etikën.
- Qendra do të zhvilloj dhe propagandoj dokumenta praktike, standarte dhe mjete menaxhuese për implementimin e vazhdueshëm të kërkimit shkencor infermier në praktikën klinike.
- Puna kërkimore shkencore dhe akademike e ofruar nga Qendra Studimore për



Shëndetin Publik do të përfocojë misionin mësimor të Fakultetit nëpërmjet përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore dhe integritet të rezultateve të punës kërkimore dhe akademike në kurset përkatëse mësimore.

- Aplikimi i hulumtimeve kërkimore e shkencore ndaj problemeve dhe shqetësimeve të shëndetit komunitar e klinik të vendit, si dhe ndaj institucioneve shkencore, arsimore, qeveritare dhe shëndetësore shërben gjithashtu për të përforcuar rolin e shërbimit publik të Fakultetit.

#### Neni 7

#### **Detyrat kryesore të QSSHP**

Detyrat kryesore të Qendrës Studimore për Shëndetin Publik janë:

- Kryerja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe zhvillimit në fushën e shëndetit në përgjithësi dhe atë të shëndetit publik në veçanti.
- Bashkëpunon me njësitë e tjera bazë të Fakultetit, institucionet e tjera kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit në veçanti me Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe promovon kërkimin në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit;
- Menaxhon financimin e projekteve, programeve dhe studimeve të Fakultetit të Shëndetit Publik, në përputhje me përparësitë e përcaktuara nga Fakulteti dhe me vlerësimin e bërë nga komisionet e përhershme përkatëse;
- Zhvillon procedurat e aplikimit, të vlerësimit fillestar, monitorimit dhe vlerësimit përfundimtar të studimeve dhe projekteve të Fakultetit të Shëndetit Publik;
- Monitoron dhe vlerëson veprimtaritë kërkimore shkencore të Fakultetit të Shëndetit Publik nëpërmjet njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë.
- Krijon dhe pasuron, në mënyrë të vazhdueshme bazën e të dhënave, të analizës dhe dokumentacionit të sistemit të Qendrës Studimore për Shëndetin Publik;
- Promovon bashkëpunimin me sektorin privat në fushën kërkimore-shkencore për shëndetin publik;
- Promovon, ofron ekspertizë, bashkërendon dhe monitoron bashkëpunimin dy dhe shumëplanësh me BE-në, vendet e veçanta dhe organizatat e huaja, në fushën kërkimore-shkencore;
- Zbaton politikat e qeverisë për mbështetjen me përparësi të shkencëtarëve më të kualifikuar, të grupeve kërkimore dhe qendrave të ekselencës, në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit për shëndetin publik;
- Zbaton politikat e qeverisë për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe të shkencëtarëve të rinj në veprimtarinë e Qendrës Studimore për Shëndetin Publik;
- Zbaton politikat nxitëse të qeverisë për kthimin trurit dhe rritjen e angazhimit të diasporës intelektuale shqiptare në zhvillimin e arsimit, të shkencës, administratës publike dhe sektorit privat në vendin tonë;
- Ofron mbështetje teknike për njësitë e tjera bazë të Fakultetit, për përmirësimin e plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor, në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit;



KREU III  
BURIMET E FINANCIMIT

Neni 8  
**Burimet bazë të financimit**

Burim financimi i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik si njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shëndetit Publik është Buxheti i Shtetit.

Gjithashtu, Qendra mund të sigurojë financime edhe nga Granti i punës kërkimore-shkencore ku përfshihen fondet për kërkimin shkencor.

Qendra mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm, nga organizata ndërkombëtare për kërkimin shkencor, nga shërbimet që mund të ofrojë, nga sponsorizimet si dhe nga të ardhurat e veprimtarive të ndryshme, si aktivitete promocionale, simpoziume, konferenca dhe seminare.



KREU IV  
STRUKTURA ORGANIZATIVE E QSSHP

Neni 9  
**Përbërja dhe struktura e QSSHP**

Autoritete drejtuese;


1. Drejtuesi i Qendrës

Përbërja;

2. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe laborante

Administrata;

3. Sekretaria



Neni 10  
**Stafi i QSSHP**

Në përbërje të stafit të QSSHP është personeli akademik, ndihmës akademik, laborante pasi Qendra përmbush standartet institucionale si njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shëndetit Publik.

Neni 11  
**Funksionet e Stafit të QSSHP**

Funksionet kryesore të Stafit të QSSHP janë:

a) Propozon pranë Dekanatit fondin e nevojshëm për punën kërkimore shkencore dhe për funksionimin e QSSHP dhe ndjek procedurat deri në miratimin përfundimtar të tyre;

b) Menaxhon financimin e studimeve dhe të projekteve kërkimore shkencore, në përputhje me:

- fondin e parashikuar në ligjin e buxhetit;
- përparësitë e përcaktuara dhe vlerësimin nga komisionet e përhershme për



- përcaktimin e politikave të kërkimit shkencor;
- c) Autorizon Drejtusin e QSSHP për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të projekteve të miratuara;
  - ç) Miraton raportin e veprimtarisë së QSSHP, që i dërgohet Dekanit dhe bëhet publik;
  - d) Miraton përbërjen e grupeve të punës për të vlerësuar projektet, sipas fushave të caktuara të shëndetit publik, në bazë të propozimit të Drejtusit të QSSHP;
  - e) Shqyrton dhe miraton raportet e monitorimit dhe të vlerësimit të studimeve dhe projekteve, të menaxhuara nga Qendra Studimore për Shëndetin Publik

#### Neni 12

### **Mbledhjet e Stafit të QSSHP**

Stafi i Qendrës dhe komisioneve të përhershme të politikave të kërkimit shkencor mbledhet në mënyrë periodike sa herë që e kërkon interesi i Qendrës.

Mbledhja drejtohet nga Drejtusi i Qendrës dhe në mungesë të tij nga njëri prej anëtarëve të stafit, i përcaktuar nga Drejtusi. Nëse Drejtusi nuk ka caktuar një anëtar, mbledhja drejtohet nga anëtari më i moshuar, që merr pjesë në mbledhje.

Stafi funksionon sipas parimit të barazisë së anëtarëve.

#### Neni 13

### **Konflikti i interesave**

Në mbledhjet e stafit të Qendrës, Drejtusi fton këshilltarë ose dhe ekspertë të jashtëm, kur kjo diktohet nga përmbajtja e rendit të ditës. Këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Anëtarët e stafit detyrohen të deklarojnë pozicionin e tyre në Qendër, kur çështje të rendit të ditës dhe vendimet e Qendrës lidhen direkt me interesat e tyre të biznesit. Në këto raste ata nuk marrin pjesë në diskutime apo në votimin e vendimeve, që merren për çështjet në shqyrtim.

#### Neni 14

### **Garantimi i Etikës dhe Konfidencialitetit**

Te gjitha studimet dhe projektet kerkimore – shkencore të menaxhuara nga Qendra Studimore për Shëndetin Publik do të sigurojnë konsideratat etike dhe bioetike që janë mënyra të cilat sigurojnë që të drejtat dhe mirëqënia e individëve apo komuniteteve që janë pjesëmarrës në studime shkencore nuk janë dhunuar.

Mbështetur në Deklaratën e Helsinkit studimet të cilat grumbullojnë informacion personal mbi subjektet, duhen dizenuar në një mënyrë etike që të mbrojnë individët pjesëmarrës në studim .

Konfidencialiteti, ruajtja e të dhënave personale të pjesëmarrësve në studime do ruhen në përputhje me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008''Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale''.





KREU V  
DREJTIMI I QENDRËS KËRKIMORE-SHKENCORE

Neni 15  
**Drejtusi i Qendrës**

Drejtuesi i Qendrës është autoriteti drejtues i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik.

Drejtuesi i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik duhet të jetë personel akademik i kategorisë Profesor në fushën e shkencave të shëndetit.

Drejtuesi i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik duhet të ketë një eksperiencë akademike apo profesionale mbi 15 vjeçare në fushën e shëndetësisë.

Procedura e përzgjedhjes është ekuivalente me përzgjedhjen e Drejtuesit të Njesisë Bazë të Universitetit.

Neni 16  
**Tagrat e përfaqësimit**

Qendra Studimore për Shëndetin Publik në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga Drejtusi i Qendrës dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej dy përfaqësuesve, i cili autorizohet nga Drejtusi.

Neni 17  
**Kompetencat**

Drejtusi i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik ka këto kompetenca:

- a) Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e QSSHP;
- b) Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Qendrës dhe ia paraqet për miratim stafit;
- c) Harton dhe i paraqet Stafit punën e QSSHP;
- d) Raporton, të paktën, dy herë në vit para komisioneve të përhershme për veprimtarinë e Qendrës;
- e) Bashkërendon punën me stafin për zbatimin, me sukses të stratagjisë së qeverisë për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin.
- f) Bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve të Qendrës si dhe realizon menaxhimin e tyre;
- g) Krijon dhe zhvillon lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike, me qëllim realizimin e detyrave dhe të objektivave të Qendrës, si dhe të rritjes, gjithnjë e më tepër, të imazhit pozitiv të Universitetit të partnerët e huaj;
- h) Garanton cilësinë e materialeve informuese e promovuese, të kryera nga Qendra, dhe shpërndarjen në kohë të tyre, institucioneve, publike dhe private, të interesuara;
- i) Përfaqëson komunitetin shkencor të Fakultetit të Shëndetit Publik në Organizmat



Ndërkombëtarë të Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit Teknologjik

- j) Përfaqëson Qendrën Studimore për Shëndetin Publik të Fakultetit të Shëndetit Publik në të gjitha takimet me përfaqësues të Institucioneve Ndërkombëtare, brenda ose jashtë vendit, dhe në mungesë të tij autorizon njërin prej dy përfaqësuesve të propozuar prej tij.

Neni 18

#### **Komisionet e Përhershme**

Projekt-propozimet e paraqitura pranë QSSHP vlerësohen nga Komisionet e Përhershme për përcaktimin e politikave të kërkimit shkencor të ngritura pranë Fakultetit të Shëndetit Publik.

Neni 19

#### **Rregullat e punësimit**

Procedurat e emërimit të personelit dhe kriteret e marrjes në punë të personelit të Qendrës janë në bazë të statutit të Universitetit.

Neni 20

#### **Etika në punë**

Në kryerjen e funksioneve të tij, nëpunësi i Qendrës duhet të respektojë rregullat e etikës në përputhje me Ligjin.Nr.9131 datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike"

Neni 21

#### **Viti financiar**

Viti financiar i Qendrës fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomik-financiar, i cili vlerësohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 22

#### **Vlerësimi i cilësisë**

Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë kërkimore-shkencore të Qendrës Studimore për Shëndetin Publik do të kryhet nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, struktura dhe funksionimi i të cilës përcaktohen në statutin e Universitetit.

Neni 23

#### **Vlefshmëria e rregullores**

Kjo rregullore pasi është diskutuar në mbledhjen e Qendrës Studimore për Shëndetin Publik firmoset nga Drejtusi i Qendrës Studimore për Shëndetin Publik dhe i dërgohet për miratim me urdhër Senatit. Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit prej Kryetarit të Senatit.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**QENDRA STUDIMORE PËR SHËNDETIN PUBLIK**

---

Neni 24

**Dispozita kalimtare**

Qendra Studimore e Shëndetit Publik ngrihet në bazë të riorganizimit të Departamentit të Shëndetit Publik, si rrjedhim do të funksionojë mbi bazën e strukturës ekzistuese të saj dhe si e tillë mund të llogaritet për qëllimin e përmbushjes së standarteve institucionale si njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shëndetit Publik.

**Drejtuese e Qendrës Studimore për Shëndetin Publik**

**Prof.Dr. Yllka Stramarko**

**Dekane e Fakultetit të Shëndetit Publik**

**Prof.asoc. Aurela Saliaj**